


Takimi i katërt publik 2015

Agjencia realizoi takimin e katërt publik për vitin 2015



Shkup, 22.12.2015 – Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale e realizoi takimin e katërt publik për vitin 2015. Fjalim përshëndetës kishte drejtori i Agjencisë dr.Zoran Trajçevski, i cili i prezantoi aktivitetet që Agjencia i ka realizuar në tremujorin e fundit, në pajtim me Programin vjetor për punë – mbikëqyrjet e realizuara; dhënien e lejeve të reja për emetim televiziv përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk përdor resurse të kufizuara; analizat e përpiluara për strukturën e të punësuarve në sektorin mediatik audio dhe audiovizuel në vitin 2014;hulumtimi i realizuar i përhapjes së radiostacioneve dhe për ndikimin në shikueshmërinë e përgjithshme të stacioneve televizive që emetojnë program në nivel shtetëror përmes satelitit ose përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik dhe të stacioneve televizive që emetojnë program në nivel rajonal dhe lokal, të dhënat e të cilëve kanë të bëjnë me tremujorin e tretë të vitit 2015; studimin e përpiluar për konstatimin e arsyeshmërisë për shpalljen e konkursit publik për ndarjen e lejes për emetim televiziv në nivel shtetëror; aktivitetet në fushën e bashkëpunimit evropian dhe ndërkombëtar, me ç’rast u theksua se ka filluar implementimi i projektit IPA 2011 për sigurimin e pajisjes për monitorimin e përmbajtjeve mediatike.

Për rëndësinë dhe përfaqësimin e gjinive në medime si  dhe rezultatet nga Analiza e lajmeve dhe reklamave në vitin 2015, përpilimi i së cilës del nga obligimi i përcaktuar në Ligjin për mundësi të barabarta të grave dhe burrave, sipas të cilit Agjencia është e obliguar që njëherë në vit të parashtrojë raporte për mënyrën e shfaqjes dhe prezantimit të grave dhe burrave nëpër programe si dhe të përpilojë analizë për çështjet gjinore në konceptet programore dhe përmbajtjet e

mjeteve të informimit publik – fjalim kishte Marina Trajkova, pjesëmarrëse në përpilimin e kësaj analize.

Me qëllim që të ngritët vetëdija te punëtorët mediatik për informimin lidhur me dallimet, mr. Irena Cvetkoviq nga Koalicionit “Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të bashkësive të margjinalizuara”, i prezantoi rezultatet nga hulumtimi i realizuar në kuadër të projektit “Reprezentimi i grupeve gjinore pakicë nëpër mediumet: Serbi, Mali i Zi dhe Maqedoni”, si dhe konstatimet që kanë të bëjnë me gjendjen në këtë sferë në Republikën e Maqedonisë.



Të pranishmit kishin mundësi që të përcjellin edhe prezantimin e Draft-Metodologjisë për monitorimin e prezantimit mediatik përmes shërbimeve programore të radios dhe televizionit gjatë proceseve zgjedhore, që e prezantoi mr. Emilija Janevska, udhëheqëse e Sektorit për çështje programore në Agjenci. Në prezantimin e saj, në mënyrë të detajuar u arsyetuan qëllimet, përfshirja dhe periudhat e monitorimit të prezantimit mediatik zgjedhor, me ç’rast pasoi një debat në lidhje me dilemat që i kishin radiodifuzerët në aspekt të Draft-Metodologjisë.

Prezantimet mund ti merni në linqet e më poshtme:

M.r Emilija Janevska

[Draft – Metodologjia për monitorim të përfaqësimit mediatik nëpërmjet serviseve programore të radiove dhe televizioneve gjat përiudhës së procesit zgjedhor](#)

M.r Irena Cvetkoviq

[Përfaqësimi i gjinive dhe grupeve të seksuale pakicë: stigmë ose mungesë](#)

Marina Trajkova

[Gjinia në media: rezultate nga analiza e gjinive në lajme dhe](#)

reklamat në vitin 2015

- Mendimet dhe qëndrimet e marra si dhe qëndimin e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele mund ti merrni këtu
- Agjenda për pjesëmarrje në Takimin e katërt publik të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele për vitin 2015 mund të merret këtu
- Fletëparaqitja për pjesëmarrje në Takimin e katërt publik të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele për vitin 2015 mund të merret këtu